



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-065

Prishtinë, më 28 maj 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 28 MAJ 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës. Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 maj 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 maj 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 maj 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare, dhe atë:

Më 31 maj 2012, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për diasporën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërtimin,
6. Rekomandimi i Komisionit të posaçëm për votimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,
7. Shqyrtimi i raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik për vitin 2011, dhe
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe të anëtarëve të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Më 1 qershor 2012, me këtë:

R e n d d i t e

1. Debat parlamentar lidhur me Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Rekomandimi i Komisionit të posaçëm për votimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare më 31 maj 2012, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Departamenti për Çështje Ligjore dhe Procedurale që, në bazë Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ta përgatisë **një këshillë ligjore** lidhur me procedimin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

2. Këshilla ligjore t'u dërgohet grupeve parlamentare deri të mërkurën, më 30 maj 2012.

3.2 Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2012

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i informoi në hollësi anëtarët e Kryesisë lidhur me raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2012.

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2012, sipas pasqyrave të paraqitura në këtë raport.

3.3 Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të datës 31 maj 2012, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit, që deri në seancën e radhës, më 31 maj 2012, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së - 2 anëtarë, GP i LDK-së - 2 anëtarë, GP i VV - 1 anëtar, GP i AAK-së - 1 anëtar, GP i KKR-së - 1 anëtar, GP i SLS-së - 1 anëtar dhe GP 6+ - 1 anëtar.

3.4 Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shpalljen publike për anëtarë të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare më 31 maj 2012, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Autorizohet Zyra e Personelit e Administratës së Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, ta shpallë konkursin për anëtarë të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Mediave.

3.5 Kërkesa e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për kompensimin e nënkryetarëve të komisionit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetarëve të Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe Sasha Milosavljeviq, t'u kompensohet puna në komision, në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-V-078, më 10 tetor 2011.

3.6 Kërkesa e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, për kompensimin e nënkryetarëve të komisionit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetarëve të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Halit Krasniqi dhe Enis Kervan, t'u kompensohet puna në komision, në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-V-078, më 10 tetor 2011.

3.7 Njoftimi me përgjigjet lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Kosovën, pjesa e Kuvendit

Kryesia u njoftua me përgjigjet e përgatitura nga Administrata e Kuvendit lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Kosovën, pjesa që ka të bëjë me Kuvendin.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **10:50** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale